

Titulli i lëndës:	Mbështjellësi i Qëndrushëm i Ndërtesave
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Ky kurs është një hyrje intensive për disipinën e Mbështjellësi i Qëndrushëm i Ndërtesave (MQN) dhe njohurive relevante drejt të kuptuarit të konceptit, elementeve dhe tërësisë së konstruksionit të mbështjellësit të objekteve arkitektonike. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimve teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e zhvillimit historik, teorisë dhe praktikës së mbështjellësve, sistemeve dhe detaleve konstruktive dhe aksesorëve tjerë të mbështjellësit të qëndrueshëm të ndërtesës ndërtesës dhe fasadës.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Ky kurs synon të ofrojë një pasqyrë të fushës së gjerë të ndërtimit të qëndrueshëm dhe zgjidhjes efikase të mbështjelljes së ndërtesës, në performancën arkitekturore, ndërtimore dhe energjetike. Kursi do të ofrojë një kuptim më të thellë të përkufizimit dhe njohurive rreth dizajnit të elementeve të mbështjellësit në kontekst dhe performancë me kosto efektive për çdo tipologji objektesh: shumë qendra rezidenciale, administrative, tregtare, spitale, shkolla, etj.
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje që në fushën e MQN të dinë të njihen me përmbajtjen kryesore të projektit arkitektonik dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që të projektojnë dhe propozojnë mbështjellësin e qëndrueshëm sipas planeve të zbatimit arkitektonik dhe ndërtimor; të njoftohet për zbatueshmërinë e standardeve dhe kodeve të efikasitetit të ndërtesave dhe energjisë; dhe të jetë në gjendje të gjejë në mënyrë konstruktive gjatë hartimit të planeve të zbatimit për mbështjellësin dhe fasadën e ndërtesave. Të kuptuarit e MQN ka: rëndësinë akademike - në masën deri në të cilën SBE nga profesionistë ose studiues të fushës specifike mund të ndihmojë në arritjen e objektivave të dëshiruara; rëndësia shoqërore - e lidhur me nivelin deri në të cilin studimi i lehtësuar nga profesionisti i MQN-së ndihmon në mbledhjen e informacionit për shoqërinë, ose mund të referohet gjithashtu si një masë deri në të cilën informacioni i mbledhur përmes MQN ndihmon në zhvillimin e të kuptuarit për shoqërinë; rëndësia praktike - shkalla deri në të cilën gjetjet e MQN mund të zbatohen në situata të jetës reale; dhe rëndësia shkencore - shkalla deri në të cilën mund të plotësoni njohuritë duke kryer SBE.
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata / Leksione teorike / Seminari Ushtrime praktike – punimin e grafikëve dhe diagrameve, eventualisht modeleve, të elementëve arkitektonike e konstruktive, sipas njësisë mësimore.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijueshmëria e studentëve 10%, Puna hulumtuese (shkrimi dhe prezantimi) 15+15=30%, Puna seminarike (projekti dhe prezantimi) 15+15=30%, dhe Provimi përfundimtar (2 teste teorike) 15+15=30%. Studentët kanë të drejtë të vlerësohen në provim përfundimtar vetëm nëse kanë përfunduar me sukses punën hulumtuese dhe seminarike.
<b>Literatura primare:</b>	[1] Violeta Nushi. Leksionet e zgjedhura, që do dorëzohen pas çdo ligjerate. [2] Charles J. Kibert. Sustainable Construction: Green Building Design and Delivery. 2016. Donale R. Wulfinghoff. Energy Efficiency Manual: for everyone who uses energy, pays for utilities, designs and builds, is interested in energy conservation and the environment. 1999. [3] Rosa U. Gutiérrez, Laura de la Plaza Hidalgo. Elements of Sustainable Architecture. 2020
<b>Literatura shtesë:</b>	[4] <a href="https://www.iea.org/countries/">https://www.iea.org/countries/</a> , Technology Roadmap, Energy Efficient building envelopes. 2013, OECD/IEA, Paris, France. <b>pp 3-53</b> [5] <a href="https://www.wbdg.org/guides-specifications/building-envelope-design-guide/building-envelope-design-guide-introduction#evol">https://www.wbdg.org/guides-specifications/building-envelope-design-guide/building-envelope-design-guide-introduction#evol</a>